



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-19468, dt. 17 Prill 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Kimete (Adem) Hasaj, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 17 Prill 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 11/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Kimete (Adem) Hasaj me qëllim të krijimit të hapësirës së nevojshme për Ndërtimin e Qendrës Kryesore Familjare si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të krijimit të hapësirës së nevojshme për Ndërtimin e Qendrës Kryesore Familjare si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: **O-71611071-01252-1-404-1-1-0** në sipërfaqe prej 49.85m² (banesë) ZK Pejë, pronë e Kimete (Adem) Hasaj do të merret për nevoja të krijimit të hapësirës së nevojshme për Ndërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.131-3 me sipërfaqe prej 4150m² ZK Zagërm pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 19.03.2025.

-Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr. 131-3 në sipërfaqe prej 4150m² ZK Zagërm është vlerësuar me 17.50 €/m² që në total i bie 72,625.00 €.

-Prona private e Kimete (Adem) Hasaj, njësia kadastrale nr.**O-71611071-01252-1-404-1-1-0** në sipërfaqe prej 49.85m² (banesë) ZK Pejë është vlerësuar: vlera e investimeve 9.970 €.

-Andaj obligohe pronarja private Kimete (Adem) Hasaj që të paguajë diferencën në shumën prej 62,655.00 € Komunës së Pejës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore–Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

*MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.*

**KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj**

